

Punësimi i kosovarëve në Gjermani dhe Kosovë: sektorët dhe pagat sipas fuqisë blerëse



Punësimi i kosovarëve në
Gjermani dhe Kosovë: sektorët
dhe pagat sipas fuqisë blerëse

Tetor 2024

— **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
Të punësuarit në sektorë të ndryshëm në Gjermani dhe Kosovë (2019–2023)	6
Sektori i shëndetësisë	6
Sektori i edukimit	7
Sektori i informimit dhe komunikimit	8
Sektori i ndërtimtarisë	8
Sektori i tregtisë	9
Sektori i prodhimit	10
Sektori i hotelerisë dhe gastronomisë	10
Përmbledhje e të punësuarve nga Ballkani Perëndimor në Gjermani	11
Përfundim	12
Shtojcat	13

Përmbledhje ekzekutive

Gjermania mbetet shteti kryesor në të cilin emigrojnë qytetarët e Kosovës. Në periudhën 2010–2022, nga të gjithë qytetarët e Kosovës që janë pajisur me leje qëndrimi në shtetet e Bashkimit Evropian (BE-së), mbi gjysma e tyre kanë fituar leje qëndrimi në këtë shtet. Gjermania është edhe shteti me diasporën më të madhe nga Kosova, me gjithsej 594 mijë persona me origjinë kosovare. Së fundmi, qeveria gjermane ka miratuar disa ndryshime të reja legjislative për të lehtësuar migrimin për arsye të punësimit. Nga qershori i këtij viti, numri i qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të cilët mund të pajisen me leje të punës në Gjermani është rritur nga 25 mijë në 50 mijë persona në vit. Për shkak të kërkesës së lartë, në vetëm dy muaj është plotësuar kuota vjetore e aplikimeve për para-aprovime të vizave të punës për qytetarët e Kosovës për vitin 2024. Gjithashtu, së fundmi është miratuar 'karta e mundësive' me sistem të pikëve vlerësuar në bazë të aftësive e cila lejon personat e huaj të qëndrojnë në Gjermani për një afat kohor një vjeçar për të kërkuar punë. Ngjashëm, është lehtësuar procedura e natyralizimit apo pajisjes me nënshtetësi gjermane duke u shkurtuar koha e pritjes nga tetë vite sa ishte më herët, në tre deri në pesë vite.

Gjermania vazhdimisht është duke lehtësuar procedurat e migrimit për punëtorë të huaj si rezultat i mungesës së fuqisë punëtore me të cilën ka kohë që po përballlet. Për punëtorë të kualifikuar, kërkesa më e theksuar është në sektorët e shëndetësisë, edukimit dhe në teknologjinë e informimit dhe komunikimit, ndërsa sektorët me nevojë për fuqi punëtore të pakualifikuar përfshijnë sektorët e ndërtimit, hotelerisë dhe gastronomisë, tregtisë dhe prodhimit.

Emigrimi i qytetarëve të Kosovës vazhdon të mbetet i lartë. Një anketë e realizuar nga Instituti GAP në fund të vitit 2023 rezultoi se më të prirur për të emigruar janë të punësuarit në sektorin e ndërtimit me 18.7%, hotelerisë dhe gastronomisë me 18.7%, tregtisë me 18.1% dhe prodhimit me 12.9%. Gjermania është destinacioni kryesor për të emigruar nga Kosova me 71.4%. Arsyet ekonomike janë indikatorët kyç në marrjen e këtij vendimi ku sipas anketës, 20% e personave të cilët deklaruan se planifikojnë të emigrojnë,

në kohën kur u anketuan kishin realizuar të hyra mujore prej 301–450 euro, ndërsa 33% e tyre nuk kishin realizuar të hyra fare.

Ky raport analizon numrin e të punësuarve dhe trendet e rritjes së punësimit në sektorët kryesor ku janë të punësuar kosovarët në Gjermani dhe brenda vendit. Gjetjet tregojnë se nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe nga shtatë sektorë në Gjermani, Kosova kryeson me numrin më të madh të të punësuarve në sektorët e ndërtimit (32,238 persona), prodhimit (17,774 persona), tregtisë (17,702 persona), dhe hotelerisë dhe gastronomisë (12,434 persona).

Për më tepër, në vitet e fundit, numri i qytetarëve të Kosovës të punësuar në sektorin e shëndetësisë në Gjermani është rritur mesatarisht 16% në vit. Rrjedhimisht, numri i të punësuarve në Gjermani në këtë sektor është sa 64% e gjithsej të të punësuarve në të njëjtin sektor në Kosovë. Ndërkaq, numri i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në Kosovë ka mbetur pothuajse i njëjtë përgjatë viteve. Ngjashëm, rritje e numrit të kosovarëve të punësuar në Gjermani është vërejtur në sektorët e edukimit (+17%), informimit dhe komunikimit (+16%), hotelerisë dhe gastronomisë (+12%), dhe prodhimit (+11%). Numri i të punësuarve në sektorin e ndërtimit në Gjermani është sa rreth 58% e gjithsej të të punësuarve në Kosovë në të njëjtin sektor. Në Kosovë, në vitet e fundit vërehet një rritje mesatare vjetore e numrit të të punësuarve në sektorin e ndërtimit (+25%); tregtisë (+21%); informimit dhe komunikimit (+14%), etj.

Raporti poashtu analizon edhe dallimet në paga në të njëjtin sektorë, në Kosovë dhe Gjermani, të përshtatura për kushtet e jetesës. Gjetjet tregojnë se dallimi në paga mesatare mujore neto ndërmjet Gjermanisë dhe Kosovës, pasi përshtaten për dallimet e kostos së jetesës, është si vijon: pagat neto në Gjermani në sektorin e shëndetësisë janë më të larta për 1,406 euro; në sektorin e edukimit për 1,740 euro; në sektorin e informimit dhe komunikimit për 1,248 euro; në sektorin e ndërtimit për 1,064 euro; në sektorin e tregtisë për 1,306 euro; në sektorin e prodhimit për 1,699 euro; dhe në sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë për 926 euro.

Hyrje

Në vitin 2015, Gjermania hapi tregun e punës për gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP) përmes Rregullores së Ballkanit Perëndimor (RRBP), nga e cila, maksimum 25 mijë qytetarë të këtyre shteteve do të mund të emigronin gjatë një viti drejt Gjermanisë – përfshirë persona të kualifikuar dhe pakualifikuar – në bazë të një oferte të vlefshme të punës.¹ Kjo rregullore fillimisht ishte parashikuar të zgjaste deri në fund të vitit 2023. Megjithatë, tri ndryshime të rëndësishme legjislative hynë në fuqi nga muaji qershor 2024. Së pari, RRBP u zgjerua duke mundësuar rritje të numrit nga 25 mijë në 50 mijë persona nga BP të cilët mund të pajisen me leje të punës në Gjermani brenda një viti.² Këtë vit, për shkak të kërkesës së lartë, në vetëm dy muaj është plotësuar kuota vjetore e aplikimeve për para-aprovime të vizave të punës për qytetarët e Kosovës.³

Së dyti, Gjermania miratoi të ashtuquajturën 'Karta e mundësive' e cila lejon qytetarët e shteteve jo-anëtare të Bashkimit Evropian të udhëtojnë dhe kërkojnë punë në Gjermani për një afat kohor një vjeçar.⁴ Nëse gjatë kësaj periudhe të njëjtë sigurojnë ofertë pune, atëherë fitojnë leje-qëndrim në Gjermani. Për t'u pajisur me këtë kartë, aplikohet një sistem i pikëve bazuar në kualifikime dhe aftësi, prej të cilave, duhen arritur minimum gjashtë pikë.⁵

Viteve të fundit, për t'u pajisur me nënshtetësi gjermane është kërkuar që një person të jetoj së paku tetë vite në Gjermani. Por, duke filluar nga 27 qershor 2024, numri i viteve është zvogëluar nga tetë në pesë vite (tre vite në raste kur të huajt janë shumë mirë të integruar).^{6, 7} Për më tepër, aplikantët për t'u bërë shtetas të natyralizuar nuk do të duhet të heqin dorë nga shtetësia e tyre e mëparshme, siç ishte kërkuar më herët.⁸

Këto ndryshime legjislative vijnë si rezultat i ndryshimeve demografike dhe strukturale në tregun e punës në Gjermani.⁹ Sipas të dhënave të Agjencisë së Punësimit të Gjermanisë, deri në tre-mujorin e tretë të vitit 2023 ishin shënuar rreth 1.7 milionë vende të lira të punës.¹⁰ Kërkesa e vazhdueshme për fuqi punëtore e detyron shtetin gjerman të tërheqë punëtorë nga shtetet e huaja, e në veçanti nga shtetet e treta. Kjo mungesë nuk mund të zëvendësohet nga punëtorë brenda BE-së sepse i gjithë rajoni po përballet me vështirësi të ngjashme demografike.¹¹ Për punëtorë të kualifikuar, kërkesa është më e theksuar në sektorët e shëndetësisë, edukimit, dhe TIK,¹² ndërsa sektorët tjerë me nevojë për fuqi punëtore përfshijnë sektorët e ndërtimitarisë, hotelarisë dhe gastronomisë, tregtisë dhe prodhimit.¹³

Emigrimi i qytetarëve nga Kosova vazhdon të jetë fenomen sfidues. Bazuar në të dhëna zyrtare, nga viti 2012 deri në vitin 2022 nga Kosova janë larguar rreth 338

1 Qendra për Zhvillim Global. [Rrugët e Migrimit: Rregullorja e Ballkanit Perëndimor](#). 2021

2 Ministria Federale e Drejtësisë e Gjermanisë. [Rregullorja e Punësimit- BeschV](#)

3 Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani, [Rregullorja për Ballkanin Perëndimor](#). 2024

4 Zyra Federale e Jashtme e Gjermanisë. [Karta e Mundësive – përmbledhje](#)

5 Ibid.

6 Ministria Federale e Brendshme dhe e Komunitetit të Gjermanisë. [Të bëhesh shtetas gjerman me natyralizim](#)

7 RT&Partnerët. [Nënshtetësia e dyfishtë dhe natyralizimi më i shpejtë](#)

8 Ibid.

9 Angenendt, Steffen. et al., [Gjermania në kërkim të fuqisë punëtore të huaj](#). Instituti Gjerman për Çështje Ndërkombëtare dhe Siguri. 2023

Ndryshimet strukturale në tregun e punës përfshijnë zëvendësimin e punëve tradicionale si pasojë e digjitalizimit, ndryshimet si rezultat i dekarbonizimit të ekonomisë dhe tjera të lidhura me pasojat e pandemisë COVID-19

10 Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani. [Tregu Gjerman i Punës në 2023](#)

11 Angenendt, Steffen. et al., [Gjermania në kërkim të fuqisë punëtore të huaj](#). Instituti Gjerman për Çështje Ndërkombëtare dhe Siguri. 2023

12 Ibid.

13 Instituti IFO. Anketa e bizneseve IFO. [Lehtësohet mungesa e punëtorëve të kualifikuar në Gjermani](#). 2024

mijë qytetarë.¹⁴ Në të njëjtën kohë, popullsia është tkurrur nga 1,739,825 banorë sa Kosova numëronte në vitin 2011, në 1,586,659 banorë në 2024.¹⁵ Për më tepër, moshë mesatare e popullsisë është rritur nga 29.97 vjeç sa ishte në vitin 2011 në moshën mesatare ekuivalente me 34.82 vjeç.¹⁶ Ndryshimet demografike sikurse tkurrja dhe plakja e popullsisë, e të cilat shkaktohen si pasojë e uljes së natalitetit dhe emigrimit në masë të madhe, paraqesin sfidë për tregun e punës në Kosovë. Në vitet e fundit, fuqia punëtore aktive dhe jo-aktive është zvogëluar, duke shkaktuar mungesë të fuqisë punëtore në Kosovë në sektorë të cilët kanë produktivitet të lartë.¹⁷

Sipas një ankete të realizuar nga Instituti GAP në fund të vitit të kaluar,¹⁸ nga 28% e qytetarëve mbi 18 vjeç të cilët deklaruan se kanë prirje për të emigruar pas liberalizimit të vizave, 71.4% u shprehën se destinacioni kryesor është Gjermania. Njëherit, Gjermania është shteti me diasporën më të madhe nga Kosova, me gjithsej 594 mijë persona me origjinë kosovare.¹⁹ Sipas Eurostat, nga viti 2010 deri në 2022, gjithsej 301,624 kosovarë janë pajisur me leje-qëndrime për herë të parë nga shtetet e BE-së. Prej tyre, 163,088 (54%) leje-qëndrime janë lëshuar nga shteti i Gjermanisë.²⁰

Bazuar në të dhënat e anketës së Institutit GAP, nga të gjithë personat mbi moshën 18 vjeç të punësuar në Kosovë me prirje për të emigruar, 18.7% prej tyre i takojnë sektorit të ndërtimtarisë; 18.7% sektorit të hotelarisë dhe gastronomisë; 18.1% sektorit të tregtisë me shumicë dhe pakicë; 12.9% sektorit të prodhimit; 7.1% sektorit të shëndetësisë; 7.1% sektorit të edukimit; dhe 6.5% sektorit të informimit dhe komunikimit. Arsyet ekonomike janë mbizotëruese në marrjen e vendimit për të emigruar. Mbi 20% e personave të anketuar të prirur për të emigruar kanë realizuar të hyra prej 301-450 euro, ndërkaq 33% deklaruan se nuk kanë realizuar fare të hyra.²¹

Shumica e të punësuarve në sektorët e ndërtimtarisë, prodhimit, tregtisë dhe hotelarisë dhe gastronomisë, deklaruan se nuk kanë pasur rritje të pagave gjatë vitit 2023 por se ju është premtuar rritje për këtë vit. Për dallim, rritje të pagave kanë deklaruar kryesisht të punësuarit në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, kjo si pasojë e ndryshimit legjislativ në pagat në sektorin publik. Sa i përket moshës, të rinjtë janë më të prirur për të emigruar, ku 33% e personave të cilët deklaruan se kanë plane për t'u larguar nga Kosova i takojnë moshës nën 24 vjeç; 31% moshës nga 25 – 34 vjeç; dhe 17% moshës nga 35 – 44 vjeç.²²

Për më tepër, disa nga arsyet kryesore të cilat i nxisin qytetarët të largohen nga Kosova janë mundësitë më të mira për punësim (28%); përmirësimi i cilësisë së arsimit, shëndetësisë dhe sigurisë (26%); zhvillimi në karrierë (14%); etj. Të njëjtët deklarojnë se nëse pagat në Kosovë do të ishin më të larta, nëse do të ofroheshin kushte më të favorshme të punës sikurse respektimi i kontratës së punës, orarit të punës, pushimit vjetor dhe të tjera të ngjashme, nuk do të ishin të motivuar për t'u larguar nga Kosova.

14 Instituti GAP. [Prirja për të emigruar nga Kosova pas liberalizimit të vizave: ndikimi në fuqinë punëtore](#), 2024

15 Agjencia e Statistikave të Kosovës, [Publikohen rezultatet paraprake të regjistrimit të popullsisë \(ReKos2024\)](#)

16 Në piramidën e popullsisë, grup-moshë deri në 15 vjeç pësoi rënie. Në vitin 2011 dominonte grup-moshë 10-19 vjeç, ndërsa në vitin 2024 dominon grup-moshë 20-24 vjeç, një indikator i plakjes së popullsisë. Ibid.

17 Instituti GAP. [Prirja për të emigruar nga Kosova pas liberalizimit të vizave: ndikimi në fuqinë punëtore](#), 2024

18 Anketa është realizuar në nivel vendi – në 38 komuna të Kosovës – duke përdorur teknikën e mostrës së shtresuar me përzgjedhje të rastësishme me nivel të besueshmërisë 95% dhe marzhë të gabimit +/-3%. Numri i të anketuarve është ekuivalent me 1,066 qytetarë të Kosovës të moshës mbi 18 vjeç, duke përfshirë edhe strukturën etnike në Kosovë

19 Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis), [Raport statistikor – mikrocensusi](#), 2023

20 Eurostat, [Statistikat e migrimit dhe popullsisë së migrimit](#).

21 Kjo vlen për të hyrat në muajin nëntor 2023

22 Nga personat tjerë të cilët deklaruan se planifikojnë të emigrojnë nga Kosova, 11% i takojnë moshës 45 – 54 vjeç; 6% moshës 55 – 64 vjeç; dhe 1% mbi moshën mbi 65 vjeç

Ky raport vë në pah trendin e punësimit të qytetarëve nga Kosova me leje-qëndrim në Gjermani nëpër sektorë të ndryshëm, për vitet 2019 – 2023.²³ Po ashtu, raporti pasqyron numrin e të punësuarve në sektorët e njëjtë në Kosovë dhe analizon dallimet në paga në këta sektorë në Kosovë dhe Gjermani. Për më tepër, raporti analizon trendin e punësimit të qytetarëve nga të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor në Gjermani dhe sektorët në të cilët ata janë të punësuar.

Të punësuarit në sektorë të ndryshëm në Gjermani dhe Kosovë (2019–2023)

Për të krahasuar fuqinë blerëse mes pagave në Kosovë dhe Gjermani, është përdorur Pariteti i Fuqisë Blerëse (ang: PPP), i cili mat koston e një shporte me produkte të njëjta të konsumit në shtete të ndryshme. Kjo 'shportë' përfshin produkte si ushqimi, strehimi, transporti, shëndetësia, veshmbathja, etj. Rroga mesatare neto në Kosovë është 468 euro, ndërsa në Gjermani është 2,822 euro (2023).²⁴ Pas përshtatjes me PPP, paga neto në Kosovë rezulton me një fuqi blerëse ekuivalente me 1,265 euro në Gjermani, çka tregon se një shportë e tillë, si më lart, mund të kushtojë gati tri herë më shumë në Gjermani. Megjithatë, edhe pas kësaj përshtatjeje, paga mesatare neto në Gjermani mbetet e lartë, gjë që tërheq një numër të madh të punëtorëve në tregun e punës atje.

Sektori i shëndetësisë

Në sektorin e shëndetësisë në Gjermani janë të punësuar gjithsej 9,416 qytetarë të Kosovës. I njëjti sektor në Kosovë punëson 14,786 persona.²⁵ Në vitet e fundit, numri i qytetarëve të Kosovës të punësuar në sektorin e shëndetësisë në Gjermani është rritur mesatarisht 16% çdo vit. Ndërkaq në Kosovë, numri i të punësuarve në këtë sektor ndër vite ka mbetur thuajse i njëjtë. Numri i kosovarëve të punësuar në këtë sektor në Gjermani është ekuivalent me 64% e gjithsej të të punësuarve në të njëjtin sektor në Kosovë. Paga mesatare mujore neto në këtë sektor në Gjermani është 2,868 euro (4,581 euro bruto),²⁶ ndërsa në Kosovë është 541 euro (607 euro bruto).²⁷ Kosto e jetesës në Kosovë është më e ulët se në Gjermani, ku matur përmes Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP), një shportë e produkteve me vlerë prej 541 euro në Kosovë është ekuivalent me vlerën prej 1,462 euro në Gjermani.²⁸ Megjithatë, dallimi në paga vazhdon të jetë i lartë. Më saktësisht, paga mesatare neto në sektorin e shëndetësisë në Gjermani është për rreth dy herë më e lartë se paga mesatare neto në Kosovë e përshtatur me koston e jetesës.

23 Këtu nuk përfshihen personat e pajisur me nënshtetësi të Gjermanisë, vetëm personat të cilët janë të pajisur me leje-qëndrim në Gjermani

24 Të dhënat për pagë mesatare janë llogaritur bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Zyrës Federale të Statistikave të Gjermanisë. PPP është shkurtësë për Paritetin e Fuqisë Blerëse apo siç njihet në terma ekonomik si Purchasing Power Parity



25 Numri i të punësuarve është llogaritur duke i'u referuar të dhënave nga [Agjencia e Punësimit në Gjermani](#) dhe [Agjencia e Statistikave të Kosovës](#), bazuar në të dhënat më të fundit në dispozicion, TM4 2023

26 Paga neto është llogaritur bazuar në normën mesatare të taksave për vitin 2023 në Gjermani e cila është ekuivalente me 37.4%. OBZhE. [Tatimi i pagave: Gjermani](#), 2024, duke i'u referuar të dhënave zyrtare të pagave bruto për sektorë, Zyra Federale e Statistikave (Destatis) në Gjermani, [Indeksi i fitimeve mesatare bruto: muaji dhe aktivitetet ekonomike](#), maj 2024

27 Të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), pagat bruto në maj 2024

28 Pariteti i Fuqisë Blerëse (PPP) është llogaritur duke i'u referuar të dhënave të [Bankës Botërore](#) për vitin 2024 ku faktori i konvertimit të PPP-së sipas BPV-së është 0.37 për Kosovën dhe 0.7 për Gjermaninë. E njëjta llogaritje vlenë për pjesën tjetër të raportit.

Figura 1. a) Kosovarët e punësuar në **sektorin e shëndetësisë** në Gjermani dhe Kosovë; b) paga mesatare mujore neto dhe paga mesatare neto e përshtatur sipas PPP





Sektori i edukimit

Në sektorin e edukimit në Gjermani janë të punësuar 1,623 qytetarë të Kosovës, krahasuar me 44,078 të cilët punojnë në të njëjtin sektor në Kosovë. Viteve të fundit, numri i qytetarëve të Kosovës të punësuar në sektorin e edukimit në Gjermani është rritur mesatarisht 17% çdo vit, ndonëse shkalla e të punësuarve nga Kosova në këtë sektor mbetet ende e ulët. Ngjashëm, edhe në Kosovë vërehet një rritje e të punësuarve në këtë sektor mesatarisht 13% në vit. Paga mesatare mujore neto në Gjermani është 3,151 euro (5,033 euro bruto), ndërsa në Kosovë është 522 euro (585 euro bruto). Përshtatur sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP), një pagë prej 522 euro në Kosovë ka fuqi blerëse sa 1,411 euro në Gjermani. Dallimi në paga vazhdon të jetë i lartë, ku paga mesatare neto në sektorin e edukimit në Gjermani është për mbi dy herë më e lartë se paga mesatare në Kosovë e përshtatur me koston e jetesës.

Burimi:
 1. Agjencia e Statistikave të Kosovës; Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani;
 2. Agjencia Federale e Statistikave të Gjermanisë, Administrata Tatimore e Kosovës


Figura 2. Kosovarët e punësuar në **sektorin e edukimit** në Gjermani dhe Kosovë; paga mesatare mujore neto dhe paga mesatare neto e përshtatur sipas PPP



Sektori i informimit dhe komunikimit

Në sektorin e informimit dhe komunikimit në Gjermani janë të punësuar gjithsej 1,117 qytetarë të Kosovës. Në të njëjtin sektor në Kosovë janë të punësuar 12,533 persona. Viteve të fundit, numri i qytetarëve të Kosovës të punësuar në këtë sektor në Gjermani është rritur mesatarisht 16% çdo vit, por shkalla e punësimit mbetet e ulët krahasuar me sektorët tjerë. Paga mesatare mujore neto në këtë sektor në Gjermani është 3,762 euro (6,010 euro bruto) ndërsa në Kosovë është 930 euro (1,062 euro bruto). Përshtatur sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP), një pagë prej 930 euro në Kosovë ka fuqi blerëse sa 2,514 euro në Gjermani. Megjithatë, dallimi në paga vazhdon të jetë i lartë, ku paga mesatare neto në sektorin e informimit dhe komunikimit në Gjermani është për 1.5 herë më e lartë se paga mesatare në Kosovë e përshtatur me koston e jetesës.

Figura 3. Kosovarët e punësuar në sektorin e informimit dhe komunikimit në Gjermani dhe Kosovë; paga mesatare mujore neto dhe paga mesatare neto e përshtatur sipas PPP




Sektori i ndërtimitarisë

Sipas të dhënave të fundit, në sektorin e ndërtimitarisë në Gjermani punojnë 32,238 qytetarë të Kosovës. Për dallim, në Kosovë numri i personave të punësuar në këtë sektor është ekuivalent me 55,128. Punësimi i qytetarëve të Kosovës në sektorin e ndërtimitarisë në Gjermani ka pasur luhatje nga viti në vit, megjithatë, gjatë periudhës 2019–2023, numri i të punësuarve është rritur me mbi nëntë mijë persona. Në anën tjetër, në Kosovë, vitet e fundit është rritur numri i të punësuarve në sektorin e ndërtimitarisë mesatarisht 25% në vit. Ndërtimtaria është sektori i dytë me më së shumti të punësuar në Kosovë dhe me trend të rritjes nga viti në vit. Megjithatë, në Gjermani numri i të punësuarve në këtë sektor është mjaft i lartë, ekuivalent me 58% e gjithsej të të punësuarve në sektorin e ndërtimitarisë në Kosovë. Paga mesatare mujore neto në këtë sektor në Gjermani është 2,445 euro (3,906 euro bruto) për dallim nga paga në Kosovë në të njëjtin sektor e cila është 511 euro (572 euro bruto). Përshtatur sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP), një pagë prej 511 euro në Kosovë ka fuqi blerëse sa 1,381 euro në Gjermani. Megjithatë, paga mesatare neto në sektorin e ndërtimitarisë në Gjermani është gati dy herë më e lartë se paga mesatare në Kosovë e përshtatur me koston e jetesës.


Burimi:

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës; Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani;
2. Agjencia Federale e Statistikave të Gjermanisë, Administrata Tatimore e Kosovës

Figura 4. Kosovarët e punësuar në **sektorin e ndërtimitarisë** në Gjermani dhe Kosovë; paga mesatare mujore neto dhe paga mesatare neto e përshtatur sipas PPP



b) Paga – maj 2024




Burimi:
 1. Agjencia e Statistikave të Kosovës; Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani;
 2. Agjencia Federale e Statistikave të Gjermanisë, Administrata Tatimore e Kosovës


Sektori i tregtisë

Sektori i tregtisë në Gjermani punëson 17,702 qytetarë të Kosovës. Për dallim, në Kosovë ky sektor punëson 87,542 persona, dhe rrjedhimisht është sektori me numrin më të madh të punësuarve nga të gjithë sektorët. Numri i qytetarëve të Kosovës të punësuar në sektorin e tregtisë në Gjermani në vitet e fundit ka një rritje mesatarisht 10%. Ndërkaq, shkalla e punësimit në të njëjtin sektor në Kosovë është rritur me ndjeshëm viteve të fundit, me rreth 21%. Paga mesatare mujore neto në Gjermani në sektorin e tregtisë është 2,633 euro (4,206 bruto), ndërsa në Kosovë është 491 euro (548 euro bruto). Përshtatur sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP), një pagë prej 491 euro në Kosovë ka fuqi blerëse sa 1,327 euro në Gjermani. Megjithatë, dallimi në paga vazhdon të jetë i lartë, ku paga mesatare neto në sektorin e tregtisë në Gjermani është për rreth dy herë më e lartë se paga mesatare në Kosovë e përshtatur me koston e jetesës.

Figura 5. Kosovarët e punësuar në **sektorin e tregtisë** në Gjermani dhe Kosovë; paga mesatare mujore neto dhe paga mesatare neto e përshtatur sipas PPP




b) Paga – maj 2024



Sektori i prodhimit

Sektori i prodhimit në Gjermani punëson 17,774 persona nga Kosova. Për dallim, në Kosovë janë gjithsej 40,028 të punësuar në këtë sektor. Rritja e numrit të qytetarëve të Kosovës në këtë sektor në Gjermani është mesatarisht 11% në vit. Numri i të punësuarve në këtë sektor në Gjermani është ekuivalent me 44% e gjithsej të të punësuarve në sektorin e njëjtë në Kosovë. Paga mesatare mujore neto në sektorin e prodhimit në Gjermani është 2,977 euro (4,756 euro bruto) ndërsa në Kosovë është ekuivalent me 473 euro (527 euro bruto). Përshtatur sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP), një pagë prej 473 euro në Kosovë ka fuqi blerëse sa 1,278 euro në Gjermani. Dallimi në paga vazhdon të jetë i lartë, ku paga mesatare neto në sektorin e prodhimit në Gjermani është për 2.3 herë më e lartë se paga mesatare në Kosovë e përshtatur me koston e jetesës.

Figura 6. Kosovarët e punësuar në **sektorin e prodhimit** në Gjermani dhe Kosovë; paga mesatare mujore neto dhe paga mesatare neto e përshtatur sipas PPP




Sektori i hotelerisë dhe gastronomisë

Në Gjermani janë gjithsej 12,434 të punësuar në sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë, ndërsa në Kosovë ky numër është 29,342 mijë persona. Në vitet e fundit vërehet rritje e të punësuarve nga Kosova në këtë sektor në Gjermani me mesatarisht 12%. Numri i të punësuarve në sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë në Gjermani mbetet i lartë, përndryshe, sa rreth 42% e gjithsej të të punësuarve në Kosovë në të njëjtin sektor. Paga mesatare mujore neto në këtë sektor në Gjermani arrinë vlerën 1,867 euro (2,983 euro bruto) për dallim nga paga në Kosovë me vlerë 348 euro (384 euro bruto). Përshtatur sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP), një pagë prej 348 euro në Kosovë ka fuqi blerëse sa 941 euro në Gjermani. Megjithatë, dallimi në paga vazhdon të jetë i lartë, ku paga mesatare neto në sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë në Gjermani është për rreth dy herë më e lartë se paga mesatare në Kosovë e përshtatur me koston e jetesës.

Burimi:

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës; Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani;
2. Agjencia Federale e Statistikave të Gjermanisë, Administrata Tatimore e Kosovës

Figura 7. Kosovarët e punësuar në **sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë** në Gjermani dhe Kosovë; pagat mesatare mujore neto dhe paga mesatare neto e përshtatur sipas PPP




Përmbledhje e të punësuarve nga Ballkani Perëndimor në Gjermani

Sektori i ndërtimtarisë në Gjermani punëson më së shumti qytetarë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, gjithsej 95,902 persona, ndjekur nga sektori i prodhimit me 66,994 persona, dhe i tregtisë me 63,097 persona. Nga gjashtë shtetet e BP-së, Kosova dominon me numrin më të madh të punësuarve në sektorët e ndërtimtarisë, prodhimit, tregtisë, dhe hotelerisë dhe gastronomisë. Rrjedhimisht, janë gjithsej 32,238 qytetarë të Kosovës të punësuar në sektorin e ndërtimtarisë; 17,774 në sektorin e prodhimit; 17,702 në sektorin e tregtisë; dhe 12,434 në sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë. Për dallim, në sektorin e shëndetësisë kryesojnë qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës, me gjithsej 13,628 të punësuar. Sektori i edukimit po ashtu numëron më së shumti të punësuar nga Bosnja dhe Hercegovina me gjithsej 2,336 persona, ndërsa sektori i informimit dhe komunikimit ka më së shumti të punësuar nga Serbia, gjithsej 2,201 persona (shih tabelat 1-7 në shtojca).

Burimi:

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës; Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani;
2. Agjencia Federale e Statistikave të Gjermanisë, Administrata Tatimore e Kosovës

Figura 8. Numri i qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të punësuar në **sektorë të ndryshëm** në Gjermani




Përfundim

Emigrimi i qytetarëve të Kosovës drejt Gjermanisë për arsye të punësimit vazhdon të jetë një fenomen sfidues. Gjermania mbetet destinacioni kryesor për punëtorët nga Kosova dhe rajoni i Ballkanit Perëndimor, për shkak të mundësive më të mira për punësim dhe paga më të larta. Me lehtësimet e fundit të procedurave të migrimit nga Gjermania, duke rritur kuotat për lejet e punës dhe ofruar mundësinë e natyralizimit më të shpejtë, gjithnjë e më shumë qytetarë të Kosovës dhe vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor janë duke kërkuar punësim në Gjermani.

Diferencat e mëdha në pagat mes Gjermanisë dhe Kosovës janë një nxitje e fuqishme për emigrimin. Sektori i ndërtimit mbetet punëdhënësi më i madh për qytetarët e Kosovës në Gjermani, ndjekur nga sektori i prodhimit dhe tregtisë. Tregu i punës së Kosovës përkundër largimit në masë të madhe të punëtorëve, nuk ka arritur t'i përshtatë pagat në mënyrë të ndjeshme që të dekurajoj largimin e tyre. Shumica e personave të prirur për të emigruar i takojnë grupit të të hyrave nën pagën mesatare në Kosovë. Pa strategji konkrete dhe masa të përmirësimit të kushteve të punës dhe të ardhurave, ky fenomen pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen.


Shtojcat

Figura 9. Numri i qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të punësuar në sektorin e shëndetësisë në Gjermani




Burimi: Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani

Figura 10. Numri i qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të punësuar në sektorin e informimit dhe komunikimit në Gjermani




Burimi: Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani

Figura 11. Numri i qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të punësuar në sektorin e edukimit në Gjermani




Burimi: Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani

Figura 12. Numri i qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të punësuar në sektorin e ndërtimit në Gjermani




Burimi: Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani

Figura 13. Numri i qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të punësuar në sektorin e tregtisë në Gjermani




Burimi: Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani

Figura 14. Numri i qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të punësuar në sektorin e prodhimit në Gjermani



Burimi: Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani

Figura 15. Numri i qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të punësuar në sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë në Gjermani



Burimi: Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339


info@institutigap.org

Instituti GAP mbështetet nga:



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World



**Punësimi i kosovarëve
në Gjermani dhe Kosovë:
sektorët dhe pagat
sipas fuqisë blerëse**